REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 737, 765, 767/20
Datë/Datum. 13.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 737/20
765/20
767/20

PANELI SHQYRTUES,i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: "Ballkan Petrol" SH.P.K- Ferizaj, OE: N.T.SH "Ekoninvest" - Prishtinë , si dhe grupi i OE: "Itrast " SH.P.K & "Selzer Turbo Venlo"B.V & "Tugran Enerjisanayi Ticaret"A.S-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: "Diestmann Technologies "S.A., Zone Industielle-Salies-Du-Salat, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Riparimi kapital i turbinës dhe gjeneratorit të bllokut A4" me nr. të prokurimit: KEK-20-620-5-1-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Korporata Energjetike e Kosovës" (KEK), më datën: 12.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.<u>APROVOHEN</u>, si pjesërisht të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: "Ballkan Petrol" SH.P.K-Ferizaj, OE: N.T.SH "Ekoninvest" - Prishtinë, si dhe grupi i OE: "Itrast " SH.P.K & "Selzer Turbo Venlo"B.V & "Tugran Enerjisanayi Ticaret"A.S-Prishtinë ,kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Riparimi kapital i turbinës dhe gjeneratorit të bllokut A4" me nr. të prokurimit: KEK-20-620-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Korporata Energjetike e Kosovës" (KEK),

II.<u>ANULOHET,</u> njoftimi për dhënie të kontratës për Aktivitetin e Prokurimit me titull: "Riparimi kapital i turbinës dhe gjeneratorit të bllokut A4" me nr. të prokurimit: KEK-20-620-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Korporata Energjetike e Kosovës" (KEK), dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konfirmon dispozitat ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues: "Ballkan Petrol" SH.P.K- Ferizaj, OE: N.T.SH "Ekoninvest"- Prishtinë, si dhe grupi i OE: "Itrast" SH.P.K & "Selzer Turbo Venlo"B.V & "Tugran Enerjisanayi Ticaret"A.S-Prishtinë, i aprovohen si pjesërisht të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues: "Ballkan Petrol" SH.P.K- Ferizaj, OE: N.T.SH "Ekoninvest" - Prishtinë, si dhe grupi i OE: "Itrast " SH.P.K & "Selzer Turbo Venlo"B.V & "Tugran Enerjisanayi Ticaret"A.S-Prishtinë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 01.10.2020, me nr.737/20, dhe me 05.10.2020 me nr. 765/20, dhe me 05.10.2020 me nr. 767/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: "Diestmann Technologies "S.A., Zone Industielle-Salies-Du-Salat, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Riparimi kapital i turbinës dhe gjeneratorit të bllokut A4" me nr. të prokurimit: KEK-20-620-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Korporata Energjetike e Kosovës" (KEK), duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 28 , 59 , si dhe nenin 72 të LPP-së , te ankesa me nr. 737/20.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7 , 59 , 60 , si dhe nenin 69 të LPP-së , te ankesa me nr. 765/20.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7 , 59 , 64 , 66 , si dhe nenin 69 të LPP-së , te ankesa me nr. 767/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 13.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik i prokurimit në raportin e dt: 23.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të operatorve ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "Ballkan Petrol" SH.P.K- Ferizaj, OE: N.T.SH "Ekoninvest" - Prishtinë , si dhe grupi i OE: "Itrast " SH.P.K & "Selzer Turbo Venlo"B.V & "Tugran Enerjisanayi Ticaret"A.S-Prishtinë ,

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE "Ballkan Petrol"shpk- Ferizaj

Pretendimi ankimor i OE ankues pretendon qe AK e ka eliminuar për shkak se OE ankues në paramasën e ofruar nuk ka vendosur çmime për disa pozicione, ndërsa OE ankues thotë se AK-ja ne paramasën e ofruar për te njëjtat pozicione nuk ka ofruar çmime(N/A), andaj AK-ja ne dosjen e tenderit ka cekur qe disa pjese opsionale nuk janë pjese e kontratës bazë.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne paramasën e ofruar nga AK-ja për te njëjtat pozicione nuk ka aplikuar çmim (N/A) andaj pretendimi ankimor i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Ky pretendim ka të beje me :

4. Operatori Ekonomik "Dietsmann Technology S.A", nuk është i përgjegjshëm sepse me rastin e dorëzimit të ofertës në kundërshtim më kërkesat e parashtruara në ANEKSIN 1 të dosjes së tenderit ku është kërkuar decidivisht që Operatorët Ekonomik e kanë për obligim që të dorëzojnë:

Deklarate për afatin e garancionit 12000 orë pune, nga dita e lëshimit të certifikatës nga TC-A për operim të rregullt me bllokun A4."

OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar fare një deklaratë për afatin e garancionit siç e ka kërkuar AK në Dosjen e Tenderit, por ka dorëzuar një dokument respektivisht Propozim Teknik, në të cilin përveç disa elementeve tjera, në piken 1.11, ka theksuar:

1.11 Technical qualifications

1.11.1 V Varranty and performances

The vvarranty period of the Products shall expire twelve-thousands (12,000) running hours after the date of installation of the Products in the equipment, or twenty-four (24) months after the delivery of the parts to the site whichever expires first.

The warranty and performance conditions are valid if and only if:

the spare parts already available at site, within Company warehouse, are conform to genuine parts

Company purchases all spares indicated by EO as deemed necessary for replacement.

Ky deklarim/theksim i OE të rekomanduar për kontratë në propozimin teknik, ku ka theksuar se garancioni do të skadojë 12,000 orë pas datës së instalimit të produktit apo 24 muaj pas liferimit, cili do që skadon i pari, është në kundërshtim të plotë me kërkesën-kushtin administrativ të parashtruar nga AK në dosjen e tenderit sepse nga kjo rrjedh se OE i rekomanduar për kontratë mund ta liferoj pajisjen dhe të skadojë afati prej 24 muaj pa ndodhur ende instalimi dhe testimi i pajisjes në bllokun A4 si dhe pa u lëshuar certifikata nga TC-A. Andaj pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Eksperti shqyrtues/teknik sqaron se kërkesë e autoritetit kontraktues ka qene:

Deklarate për afatin e garancionit 12000 orë pune , nga dita e lëshimit të certifikatës nga TC-A për operim të rregullt me bllokun A4.

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate në ofertën e tij ka ofruar garancion dymbëdhjetë mijë (12,000) orë pune pas datës së instalimit, ose njëzet e katër (24) muaj pas dorëzimit të pjesëve në sit, cilado që skadon e para.

Ne vazhdimi kemi paraqitur deklaratën e operatorit ekonomik i rekomanduar për kontrate:

1.11 Technical qualifications

1.11.1 Warranty and performances

The warranty period of the Products shall expire twelve-thousands (12,000) running hours after the date of installation of the Products in the equipment, or twenty-four (24) months after the delivery of the parts to the site whichever expires first.

The warranty and performance conditions are valid if and only if: the spare parts already available at site, within Company warehouse, are conform to genuine parts Company purchases all spares indicated by EO as deemed necessary for replacement. Andaj pretendimi ankimor i OE ankues ne këtë pikë është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor ka të bëjë me :

1. Po ashtu OE "Dietsmann Technology S.A" i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm sepse nuk ka dorëzuar dëshmi lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional. respektivisht lidhur me kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT për pikën:

2. Lista e personelit qe do te angazhohet ne realizimin e projektit: a) Menaxheri i projektit, duhet te këtë përvojë ne udhëheqjen e se paku tri riparimeve kapitale te turbinës dhe gjeneratorit elektrik. Te dëshmohet me CV, kopje te diplomës dhe kontratë pune."

OE i rekomanduar për kontratë lidhur më kërkesën/dëshminë e lartë cekur nuk ka dorëzuar fare listë me emra të personelit qe do ti angazhon në këtë projekt- përveç që në dokument propozimin teknik ka specifikuar llojet e profesioneve të stafit që nevojiten për implementimin e projektit, por pa e specifikuar asnjë emër të

personave/stafit që i ka në dispozicion, respektivisht që do ti angazhon në implementimin e projektit dhe që janë të profesioneve siç i ka specifikuar profesionet edhe vet OE në propozimin teknik.

Eksperti shqyrtues/teknik sqaron se kërkesë e AK-së është:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 .

Kualifikimet shkollore dhe profesionale te personelit.

Lista e personelit qe do te angazhohet ne realizimin e projektit.

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ne ofertën e tije ka ofruar listën e personelit dhe kualifikimet shkollore dhe profesionale te personelit të cilët do të angazhohen ne realizimin e projektit.

Nuk ka qenë kërkese e dosjes se tenderit qe lista e punëtoreve të jete me emrat e punëtoreve që do te angazhohen por vetëm personeli për realizimin e këtij projekti. Rrjedhimisht ky pretendim ankimor nuk është i qëndrueshëm.

Pretendimi ankimore ka te beje :

Po ashtu, OE i rekomanduar për kontratë, lidhur me projekt menaxherin **z.** Karim Mikati të caktuar për menaxhim të kontratës, nuk ka ofruar dëshmi se i njëjti ka përvojë në udhëheqjen e së paku tri riparimeve kapitale të turbinës dhe gjeneratorit elektrik siç është kërkuar nga AK.

Eksperti shqyrtues/teknik sqaron se kërkesë e autoritetit kontraktues ka qene:

Menaxheri i projektit, duhet të ketë përvojë ne udhëheqjen e se paku tri riparimeve kapitale te turbinës dhe gjeneratorit elektrik. Te dëshmohet me CV, kopje te diplomës dhe kontratë pune, për të sqaruar me mirë ketë pikë Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtese për menaxherin e projektit.

3. In regard to Project Manager, the following documents are required: the copy of the diploma as well as the employment contract with the company "Dietsmann Techologies".

pas sqarimeve shtese operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate është përgjigjur dhe ka deklaruar se menaxheri i projektit ka realizua minimumi 3 projekte për riparim te turbinës gjeneratorit T-GJ, po ashtu ne ofertën e tij ka ofruar CV për menaxherin e projekti. Andaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE *"N.T.SH* Ekoninvest"- Prishtinë,

Pretendim ankimor ka te bëjë:

Sa i përket referencave të paraqitura nga OE i rekomanduar për kontratë, ne pas analizës të të gjitha dokumenteve të dërguara për "referenca" kemi vërejtur që ansnjëra nga këto dokumente nuk përmbush kushtet e paraqitura nga vet AK, ku kërkohen 2 referenca që dëshmojnë se është kryer punë në remontit kapital të turbinës dhe gjeneratorit.

Eksperti shqyrtues/teknik sqaron se kërkesa e autoritetit kontraktues ka qene:

Se paku 2 (dy) referenca ne vlere prej 3,000,000.00 € për përfundimin me sukses te punëve ne riparime kapitale te turbinës dhe gjeneratorëve elektrik me kapacitet te ngjashëm ne periudhën e shkuar trevjeçare nga data e publikimit te njoftimit për kontrate. Te dëshmohet me reference të lëshuar nga punëdhënësi për kryerjen me sukses te punëve.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues/teknik sqaron se OE i rekomanduar për kontrate ne ofertën e tij ka ofruar dy referenca qe dëshmojnë se është kryer pune ne riparimin kapital te turbinës dhe gjeneratorit.

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ne ofertën e tije ka ofruar referenca për riparime kapitale te turbinës dhe gjeneratorëve me kapacitetet të ngjashme.

Referenca për nr. te kontratës 4620007430 e datës 29.12.2017 lëshuar nga AK- PJSC Enel Rusi për riparimin kapital te pajisjeve TGB 300 njësia nr. 3 ku është bere riparimi i TGJ. (REF 9 i referohet OE ankues-Dëshmia).

Certifikata për përfundimin e punëve për njësinë nr. 10 gjatë riparimit kapital për periudhën 01.07.2017-09.10.2017, T'300-240 lëshuar nga AK- PJSC Enel Rusi. (REF 10 i referohet OE ankues-Dëshmia).

Certifikata për përfundimin e punëve për njësinë nr. 8 gjate riparimit kapital për TGJ TG-8, e lëshuar me date 29.06.2018 nga AK PJSC Enel Rusi.(REF 14 i referohet OE ankues-Dëshmia).

Ndërsa referencat tjera dhe autoriteti kontraktues nuk i ka pranuar pasi qe nuk i ka cilësuar te natyrës se ngjashme dhe te cilat kane qene me te vjetra se tre vite. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi i dyte ka te beje me :

Sa i përket Projekt Menaxherit pas kërkesës ne pyetjen sqaruese OE është përgjigjur dhe ka deklaratën se ka realizuar minimum tri projekte për riparim te turbine gjenerator T-GJ ku plotësohet kushti i kërkuar për PM sepse me dëshminë e ofruar ne CV dhe deklaratën ne pyetjet sqaruese komisioni konstaton se është plotësuar ky kusht, ne kërkesën e dosjes se tenderit është kërkuar qe projekt menaxheri përmes CV dhe deklaratave te dëshmoj punën e tij. PM Karim Mikati ne CV e dhënë ka deklarua se nga viti 2017 -prezent është i punësuar ne Dietsmann Technologies S.A., këtë e dëshmon edhe kontrata e bashkangjitur ne pyetjet sqaruese.

Eksperti shqyrtues/teknik sqaron se kërkesë e autoritetit kontraktues ka qene:

Menaxheri i projektit, duhet të ketë përvojë ne udhëheqjen e se paku tri riparimeve kapitale te turbinës dhe gjeneratorit elektrik. Te dëshmohet me CV, kopje te diplomës dhe kontratë pune, për të sqaruar me mirë ketë pikë, autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtese për menaxherin e projektit.

3. In regard to Project Manager, the following documents are required: the copy of the diploma as well as the employment contract with the company "Dietsmann Techologies".

Pas sqarimeve shtese operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate është përgjigjur dhe ka deklaruar se menaxheri i projektit ka realizua minimumi 3 projekte për riparim te turbinës gjeneratorit T-GJ, po ashtu ne

ofertën e tij ka ofruar CV për menaxherin e projekti. Andaj pretendimi ankimor i OE ankues është i pa bazuar.

Përgjigje ne pretendimet e GOE "Intrast shpk&Sulzer Turbo Venlo B.V&Turgan Enerji Sanay Ticaret A.S"

Ky pretendim ka te bëjë me :

OE ankues pretendon qe i rekomanduari per kontrate ka paraqitur ISO 9001 dhe 14001 te skaduar me 17.04.2020 qe eshte para dates se ofertimit e cila ka qen 28.05.2020.

Eksperti shqyrtues sqaron se i rekomanduari per kontrate ne momentin e ofertimit ka ofruar ISO certifikata me afat te skaduar, dhe me pas AK–ja i ka kerkuar informata shtesë OE te rekomanduar per kontrate lidhur me Certifikatat ISO.I rekomanduari per kontrate i ka ofruar AK-së certifikatat ISO me validitet.Andaj pretendimi ankimor eshte i pa bazuar.

Ne dosje te tenderit ne aneksin 1 - Specifikimet teknike te detyrueshme shprehimisht janë kërkuar:

Deklarata qe posedon pajisje për balancim të rotorit deri në 3000 rrotullim.

d) Deklaratë se posedon të gjitha veglat dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e riparimit kapital.

OE nuk e ka deklaratën qe posedon pajisje për balancim te rotorit.

Ne dokumentin KEK-20-620-5-1-1jQualification Evidence _ Technical ProposalrevOO, ne një resht ka thënë :

. EO states to get available, via suitable subcontractor, a rotor balancing equipment up to 3000 revolutions.

Përkthe. OE deklaron se do ta këtë ne dispozicion, përmes një nënkontraktoni te përshtatshëm pajisjen për balancim te rotorit deri ne 3000 rrotullime. Me këtë rast nuk e ka përmendur fare se cili është nënkontraktoi, për me tepër ne dosje te tenderit është kërkuar qe OE ta këtë pajisjen për Balancim te rotori.

Eksperti shqyrtues/ teknik sqaron se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate deklaron që të marrë në dispozicion, përmes nënkontraktonit të përshtatshëm, një pajisje të balancimit të rotorit deri në 3000 rrotullime.

OE deklaron që të marrë në dispozicion, përmes nënkontraktonit të përshtatshëm, kornizën e specializuar për punët e mëposhtme: diagnostifikimi, salduesit e certifikuar, riparimi, ngarkimi i sistemit të turbinës vajore mekanike-hidraulike ngarkimi për ngarkesë 200 MW. Andaj, pretendim ankimor i OE ankues është i pa bazuar.

Ky pretendim ka të bëjë me :

OE është i obliguar të garantojë vibrimet horizontale dhe vertikale në të gjitha kushinetat e turbogjeneratorit, të cilat duhet te jenë nën ose rreth 3.8 mm/s.(ZONA A)

OE nuk ka deklaruar se do ti garantoje vibrimet horizontale dhe vertikale vertikale në të gjitha kushinetat e turbogjeneratorit, të cilat duhet te jenë nën ose rreth 3.8 mm/s.(ZONA A)

OE është i obliguar që për temperatura të vajit 45 °C pas ftohësve të vajit, temperatura e materialit të bardhe të kushinetave të turbogjeneratorit duhet të jetë < 75 °C, derisa temperatura e vajit në dalje nga kushinetat duhet të jetë nën < 60 °C.

OE nuk ka deklaruar se do ti garantoje që për temperatura të vajit 45°C pas ftohësve të vajit, temperatura e materialit të bardhe të kushinetave të turbogjeneratorit duhet të jetë < 75°C, derisa temperatura e vajit në dalje nga kushinetat duhet të jetë nën < 60 °C.

Eksperti shqyrtues/teknik sqaron se kërkesë e autoritetit kontraktues ka qene tek aneksi 1.

Të gjitha pikat e poshtë shënuara na nr. 1 deri tek nr. 9 duhet ekzekutuar nga operatori ekonomik.

1. Matjet diletative ne turbine
2. Vibracionet ne Turbine (kushineta).
3. Temperaturat e metalit te bardhe
4. Temperaturat e gjeneratorit ne stator (FE-CU).
5. Temperaturat e Hidrogjenit (gazrave)
6. Temperaturat ujit për ftohje te hidrogjenit
7. Temperaturat e vajit ne kushinetat puthiteshe
8. Matja e temperaturës ne shtypjen e mesme dhe te larte .
9. Matja e temperaturës ne gjenerator

Eksperti shqyrtues/teknik sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate ka sqaruar ne piken 48 .

48. Recording and adjustment of static properties of control system after oil flushing of integral pipe system, lubrication system, governing system, and oil sealing system for generator - cold condition. Andaj pretendimi ankimor i OE ankues është i pa bazuar.

Ky pretendim ka të bëjë me: OE ka prezantuar një liste te referencave prej 5 projekteve te përfunduara.

Referenca ne liste me nr. 3 OE Dietsmann ka qene ne konzorcium me OE URALENERGOREMOT JSC, ku ne përkthimet e dërguara shihet qarte se te gjitha punët janë kryer nga kompania URALENERGOREMOT JSC, e jo nga OE Dietsmann.

Referencat tjera me nr. 4,5,6 janë vetëm te valvave te turbinës e gjeneratorit, nuk janë remonte kapitale.

Ekspert shqyrtues/teknik sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ne ofertën e tij ka ofruar dy referenca qe dëshmojnë se është kryer pune ne riparimin kapital te turbinës dhe gjeneratorit.

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ne ofertën e tij ka ofruar referenca për riparime kapitale te turbinës dhe gjeneratorëve me kapacitetet të ngjashme.

Referenca për nr. te kontratës 4620007430 e datës 29.12.2017 lëshuar nga AK- PJSC Enel Rusi për riparimin kapital te pajisjeve TGB 300 njësia nr. 3 ku është bere riparimi i TGJ.

Certifikata për përfundimin e punëve për njësinë nr.10 gjatë riparimit kapital për periudhën 01.07.2017-09.10.2017, T'300-240 lëshuar nga AK- PJSC Enel Rusi.

Certifikata për përfundimin e punëve për njësinë nr. 8 gjate riparimit kapital për TGJ TG-8, e lëshuar me date 29.06.2018 nga AK PJSC Enel Rusi.

Pretendimi ankimor ka te bej me:

Dokumenti i cekur ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar ku keni kërkuar ndryshimin e çmimit është dorëzuar ne ofertën e juaj dhe komisioni ofertën e juaj e ka shqyrtuar ne tërësi dhe ka arsyetuar se nuk lejohet ndryshimi i çmimit, ndërsa deklarata e juaj për kushtet e përgjithshme Declaration on the "General conditions of sealer and terms of delivery" e datës 16.09.2020 nuk mund te pranohet pasi qe substancialisht ndikon ne çmimin e ofertës te dorëzuar me date 28.05.2020. Eksperti shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ankues, ka ofruar Declaration on the "General conditions of sealer and terms of delivery" e datës 16.09.2020, e cila për AK ndikon ne çmimin e ofertës ndërsa OE ankues thotë se këtë deklaratë e kanë bere për anëtarët e konzorciumit, Andaj pretendimi ankimor ne këtë pik është i pa bazuar .

Pretendimi ankimore ka të bëjë me :

Pika 2.

- For the member of the consortium Turgan Energi sanayi Ticaret reference number 46, issued by: AK-Karachi "Nuclear Powerplant Pakistan" is not acceptable as it is not of similar capacity, it has a capacity of 135 MW, while the Turbogenerator in TCA is 200 MW which is for 32.5% smaller;

JU je dosje te tenderit keni kerkuar referenca per turbina dhe gjenerator te kapacitetit te ngjashem, nuk e keni specifikuar se sa duhet te jete minimumi i kapacitetit te turbogjenratorit, rrjedhimisht parimi i punes dhe madhesia eshte e ngjashme.

Pika 3 dhe 4.

- Reference No. 1 in the list issued by T + Group Russia for the Economic Operator "Sulzer Turbo Service" has no data that meets our requirements, also lacks the contract number, capacity and year of completion of the contract;
- Reference no.2 in the list of References does not have sufficient data and was issued on: 28.07.2017 by "PJSC - Power Machine Russia" for the consortium Power Machine and Sulzer Turbo Service, also lacks the contract number, capacity and year of implementation, so it is not a Major Overhaul but a preventive maintenance;

Referancat e prezantuara dhe te realizuara nga Sulzer, e kane te bashkangjitur edhe nje dokument shpjegues, ne te cilin qarte shkruan se nese ka mangesi apo nse doni te vertetoni mund ti pyetni leshuesit e referencave qe ne kete rast jane kompanite Prodhuese te energjise si: T+Group Russia, dhe PJCS Power Machine Russia. Kontaktet e tyre jane ne referenca.

Eksperti shqyrtues/teknik sqaron referenca e operatori ekonomik ankues nuk janë konform DT-se sepse nuk përmbajnë te dhënë te mjaftueshme të cilat e përmbushin kërkesën e dosjes se tenderit.

Ref. 2 nuk ka te dhëna te mjaftueshme edhe është lëshuar 28.07.2017, i mungon numri i kontratës kapacitet dhe viti i zbatimit dhe nuk është një riparim kryesor por vetëm një mirëmbajtje parandaluese.

Pika2. Nuclear poker plan Pakistan nuk është i pranueshëm pasi nuk është i kapacitetit te njëjtë i cili ka një kapitet prej 135MW ndërsa tubo gjeneratorët ne TCA është 200MW qe është për 32.5% me i vogël, andaj nuk i përmbushë kërkesa e dosjes se tenderit .

Pretendimi ankimore ka te beje me :
Pika 5.

You have declared for the guarantee for parts replacernent withln the warranty period 12000 hours, while 12000 working hours are required after their replacement (Albaman language version prevarls).

Në dokumentin e garancionit e kemi kopjuar pikërisht ashtu siç është kërkuar ne dosje te tenderit, ashtu siç kemi deklaruar dhe e cila nënkuptohet qe garancioni fillon pas lëshimit te të certifikatës nga TC-A për operim të rregullt me bllokun A4, për 12000 ore pune, ashtu siç është kërkuar ne dosje te tenderit.

Eksperti shqyrtues /Teknik sqaron se kërkesë e autoriteti kontraktues ka qene 12000 ore pune kërkohet pas zëvendësimit te tyre, ndërsa operatori ekonomik ankues ka deklarua për garancinë për ndërrimin e pjesëve brenda periudhës se garancisë 12000, qe është ne kundërshtim me kërkesën e DT. Andaj ky pretendim ankimore është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE-ve ankues janë pjesërisht te bazuar, dhe rekomandon qe te mbetet ne fuqi vendimi i AK-së, njoftimi për dhënie të kontratës.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 23.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 27.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, "Ballkan Petrol "- SH.P.K- Ferizaj, me datë : 26.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues-teknik.

Sent: Monday, October 26, 2020 4:31 PM
To: OSHP
Cc: Ardian Behra; Blerim Dina; Nuhi Paqarizi; Goran Milenkovic; Gjemajli Bellanica; lavdim fejza
Subject: Re: 737 765 767/20 ekspertiza

Te nderuar,

Për shkak se Eksperti Shqyrtues nuk e ka trajtuar asnjërën nga pretendimet tona dhe vetëm i ka tejkaluar sipërfaqësisht ato, prandaj **nuk pajtohemi** me konstatimet e tij dhe me këtë rast kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të trajtohen edhe njëherë pretendimet tona.

Bashkangjitur kundërshtimi ndaj mendimit të Ekspertit Shqyrtues.

Me respekt,
Imri Haliti
Ballkan Petrol SH.P.K.

Operatori Ekonomik, N.T.SH "Ekoinvest"- SH.P.K- Prishtinë, me datë : 227.10.2020, me anë të parashtresës, kanë njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues-teknik.

EKO INVEST

Për: Panelin Shqyrtues të OSHP-së

Ankesa: 737-765-767/20

Ref.Prok: KEK-20-620-5-1-1

Titulli: Riparimi Kapital i Turbinës dhe Gjeneratorit të bllokut A4

Refuzimi i ekspertizës së ekspertit shqyrtues të datës 23.10.2020

Kërkojmë nga paneli i OSHP-se qe lidhur me ankesën 737-765-767/20 për aktivitetin e prokurimit nr. KEK-20-620-5-1-1 me titull "Riparimi Kapital i Turbinës dhe Gjeneratorit te bllokut A4" te organizohet seance dëgjimore me qëllim te ballafaqimit të provave dhe fakteve me ekspertin shqyrtues teknik dhe atë të prokurimit dhe në te njëjtën kohë me autoritetin kontraktues.

Lidhur me ketë njoftojmë panelin shqyrtues se kundërshtojmë ne tërësi raportin e ekspertizës se ekspertit shqyrtues dhe Teknik se një ekspertize e tille është joprofesionale e njëanshme dhe nuk përket me provat dhe argumentet e parashtruara ne ankesën tone dhe pretendimeve tona ankimore. Për me tepër, me qellim qe panelit shqyrtues ti lehtësojmë punën ne vendimmarrje dhe te këtë një pasqyre sa me te qarte ne aspektin Teknik profesional te lendes kërkojmë qe te mbahet seance dëgjimore për këtë çështje.

Gjithashtu kërkojmë nga paneli shqyrtues qe edhe përkundër situatës te respektohen masat Anti-Covid gjate seancës dëgjimore qe kanë të bëjnë me distancën dhe përdorimin e maskave. Jemi te bindur se OSHP dhe Paneli Shqyrtues kanë hapësira të mjaftueshme që të organizohet një seance dëgjimore e cila nuk do te rrezikon shëndetin e pjesëmarrësve gjatë kësaj seance.

Më poshtë kemi shënuar mospajtimet tona me ekspertizën e ekspertëve shqyrtues.

Eksperti shqyrtues në vlerësimin e pretendimeve ankimore tona sa i përket referencave cekë se AK ka pranuar vetëm tri referencat (REF 9, REF 10 dhe REF 14) si më poshtë:

Referenca për kontratë 4620007430 e datës 29.12.2017 ("REF 9" në ankesën tone).

Kjo reference dhe dokumenti i bashkëngjitur me të, shumë qartë përshkruajnë punët që janë kryer VETËM NË GJENERATOR DHE JO REMONT KAPITAL NE TURBINE DHE GJENERATOR.

Si e tillë nuk përmbush kërkesat e KEK që referenca të jetë për punët e kryera në Turbinë dhe Gjenerator.

Referenca për kontratë ("REF 10" në ankesën tone) nuk ka të bëjë fare me remont kapital. Kjo reference ka të bëjë me sistemin e distribuimit të avullit dhe këtu ka pas punë në valva dhe gypa pra JO REMONT KAPITAL I TURBINES DHE GJENERATORIT. Si e tillë kjo reference nuk përmbush kushtet e përcaktuara nga vet AK dhe si e tillë nuk vjen në shprehje të pranohet.

Referenca për kontratë ("REF 14" në ankesën tone) nuk ka të bëjë fare me remont kapital. Kjo reference ka përmbajtje disa riparime në turbine dhe vetëm në turbine por nuk është **REMONT** KAPITAL I TURBINES DHE GJENERATORIT. Si e tillë kjo reference nuk përmbush kushtet e përcaktuara nga vet AK dhe si e tillë nuk vjen në shprehje të pranohet.

Paneli Shqyrtues nuk duhet të marrë parasysh mendimin e ekspertit sa i përket këtij pretendimi ankimor sepse i njëjti do të vendoste Panelin Shqyrtues në lajthitje dhe do të paraqiste shkelje të LPP-së.

Sa i përket pretendimit të dytë, eksperti shqyrtues e thërret si dëshmi kërkesën për sqarim që i është bërë OE të rekomanduar për kontratë dhe përgjigjes që është dhënë. Duhet të theksojmë që CV-ja e dërguar me dosjen e tenderit NUK KA PERMBUSHUR KERKESAT dhe si e tillë është dashur të refuzohet në bazë të nenit 72 të LPP dhe nenit 39 të RRUOPP. Përgjigja e dhënë në sqarime shtesë përbën ndryshim material dhe plotësim të dokumentacionit dhe si e tillë është jo e ligjshme. Po ashtu përgjigja e dhënë është deklaratë nga vet personi Karim Mikati, I deklaruari për menaxhertë projektit, I cili vetëm deklaron se "ka eksperiencë" pa ofruar dëshmi konkrete. "Kontrata" e bashkëngjitur me përgjigje shtesë nuk dëshmon për eksperiencën e tij, përkundrazi dëshmon se i njëjti është angazhuar me një projekt që nuk ka të bëjë fare me remonte kapitale.

Paneli Shqyrtues nuk duhet të marrë parasysh mendimin e ekspertit sa i përket këtij pretendimi ankimor sepse i njëjti do të vendoste Panelin Shqyrtues në lajthitje dhe do të paraqiste shkelje të LPP-së.

Eksperti shqyrtues nuk ka shqyrtuar fare pretendimin tone ankimor sa i përket mungesës së dëshmive për pajisjet mobile për përpunimet e CPL, CPM dhe CPU. OE ka qenë i obliguar të ofrojë dëshmi për posedim të këtyre pajisjeve. •• -ct-irde?T---

Kjo përbën shkelje të Rregullores së punës së OSHP-së, Neni 19, pika 1.

Eksperti shqyrtues nuk ka shqyrtuar fare pretendimin tone ankimor sa i përket mungesës së dëshmive për pajisjet për matjen e vibrimeve për analizë dhe balancim. OE ka qenë i obliguar të ofrojë dëshmi për posedim të këtyre pajisjeve.

Kjo përbën shkelje të Rregullores së punës së OSHP-së, Neni 19, pika 1.

Eksperti shqyrtues nuk ka shqyrtuar fare pretendimin tone ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk posedon pajisje për balancim deri në 3000 rrotullime ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit. Për më

tepër, ky OE ka pranuar se nuk i ka ato pajisje dhe ka deklaruar se do të tentojë të ketë në dispozicion përmes nënkontraktorëve këto pajisje. Kjo deklaratë nuk ofron kurrfarë sigurie që pajisjet do të jenë në dispozicion për të kryer punën dhe për më tepër është në kundërshti të plotë me kërkesën e KEK që të dëshmohet se pajisjet i ka OE i rekomanduar për kontratë.

Kjo përbën shkelje të Rregullores së punës së OSHP-së, Neni 19, pika 1.

Eksperti shqyrtues nuk ka shqyrtuar fare pretendimin tone ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk posedon deklaratën për posedimin e stafit, mirëpo ky OE ka deklaruar se do të tentojë të sigurojë stafin. Kjo deklaratë e OE të rekomanduar për kontratë nuk ofron siguri se do të ketë kuadrin e specializuar për punët në këtë kontratë dhe është në kundërshti të plotë me kërkesat e AK për këtë pike. Kjo përbën shkelje të Rregullores së punës së OSHPsë, Neni 19, pika 1.

Eksperti shqyrtues nuk ka shqyrtuar fare pretendimin tone ankimor se OE i rekomanduar për kontratë do të posedojë pajisjet në pozicionet 14 deri 17 ashtu siç kërkohet në dosjen e tenderit. Ky OE ka ofruar deklaratë se do të sigurojë këto pajisje përmes palëve të treta nënkontraktore, gjë e cila nuk ofron siguri se këto pajisje do të sigurohen dhe nuk ka ofruar dëshmi se këto pajisje ky OE i ka.

Kjo përbën shkelje të Rregullores së punës së OSHP-së, Neni 19, pika 1.

Eksperti shqyrtues nuk ka shqyrtuar fare dëshmitë e dhëna nga ne sa i përket kundërshtimeve tona në lidhje me eliminimin tone të padrejtë.

Kjo përbën shkelje të Rregullores së punës së OSHP-së, Neni 19, pika 1.

Andaj konsiderojmë se kjo ekspertizë nuk shqyrton në mënyrë faktuale ankesën tone dhe si e tillë nuk duhet të merret parasysh nga paneli shqyrtues për të arritur një vendim meritor.

Me Respekt,
Bahri Asllani

EKOINVEST

Administrimi Tregtiare Shërbyese EKO INVEST PRISHTINË

Operatorët Ekonomik, "Itrast " SH.P.K & "Selzer Turbo Venlo"B.V & "Tugran Enerjisanayi Ticaret"A.S-Prishtinë, nuk është deklaruar lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit,

ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Lidhur me pretendimin ankimor te **OE ankues "Ballkan Petrol"shpk- Ferizaj**, se AK e ka eliminuar për shkak se OE ankuese në paramasën e ofruar nuk ka vendosur çmime për disa pozicione opcionale, ndërsa OE ankues thotë se AK-ja ne paramasën e ofruar për te njëjtat pozicione nuk ka ofruar çmime (N/A), si dhe AK ka vepruar ne kundershtim me sqarimin e vetë të ofruar në dosjen e tenderit ku ka cekur se pjestë opsionale nuk janë pjese e kontratës bazë, po ashtu me rastin e hapjes së ofertave dhe hartimin e proceverbalit të hapjes çmimet për pjeset opcionale nuk janë lexuar fare, paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ka pas paqartësi apo gabime ne paramasën e ofruar nga AK-ja respektivisht në tabelen e pjesëve opcionale ku për te njëjtat pozicione respektivisht përshkrime të pozicioneve/mallrave të ngjajshme dikun kanë vendosur inicialet (N/A) e dikun kanë kerkuar vendosje të çmimeve, po ashtu AK në dosjen e tenderit e kanë specifikuar se *"Tabela e përshkrimit të çmimeve për Pjesët Opcionale nuk janë pjesë e kontratës bazë dhe se të njëjtat do të shfrytëzohen vetëm në rast nevojë në fazat e mëtutjeshme nëse paraqitet nevoja pas një dakordimi paraprak mes Operatorit Ekonomik dhe Autoritetit Kontraktues"*, po ashtu AK me rastin e hapjes së ofertave dhe hartimin te proceverbalit të hapjes, çmimet për pjeset opcionale nuk i ka lexuar fare dhe as që i ka vendosur në proceverbalin e hapjes, nga kjo rrjedhimisht elimini i OE ankuese nga AK me arsytimin se e njejta nuk i ka plotësuar me çmime disa pozicione të pjesëve opcionale është në kundërshtim me sqarimin e dhën nga vetë AK në dosjen e tenderit se *"Tabela e përshkrimit të çmimeve për Pjesët Opcionale nuk janë pjesë e kontratës bazë"* nga i cili sqarim rrjedh se tabela e pjesëve opcionale nuk ka qenë kriter vlerësimi dhe po ashtu nga kjo rrjedh se AK ka vepruarë në kundershtim edhe me paragrafin 3 të nenit 56 të LPP-së ku thuhet: *"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*. Andaj pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues se Operatori Ekonomik "Dietsmann Technology S.A" i rekomanduar për kontratë, nuk është i përgjegjshëm sepse me rastin e dorëzimit të ofertës në kundërshtim më kërkesat e parashtruara në ANEKSIN 1 të dosjes së tenderit ku është kërkuar decidivisht që Operatorët Ekonomik e kanë për obligim që të dorëzojnë:

"Deklarate për afatin e garancionit 12000 orë pune, nga dita e lëshimit të certifikatës nga TC-A për operim të rregullt me bllokun A4."

OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar fare një deklaratë për afatin e garancionit siç e ka kërkuar AK në Dosjen e Tenderit, por ka dorëzuar një dokument respektivisht Propozim Teknik, në të cilin përveç disa elementeve tjera, në piken 1.11, ka theksuar:

1.11 Technical qualifications

1.11.1 V Varranty and performances

The vvarranty period of the Products shall expire twelve-thousands (12,000) running hours after the date of installation of the Products in the equipment, or twenty-four (24) months after the delivery of the parts to the site whichever expires first.

The warranty and performance conditions are valid if and only if:

- the spare parts already available at site, within Company warehouse, are conform to genuine parts.
- Company purchases all spares indicated by EO as deemed necessary for replacement.

Ky deklarim/theksim i OE të rekomanduar për kontratë në propozimin teknik, ku ka theksuar se garancioni do të skadojë 12,000 orë pas datës së instalimit të produktit apo 24 muaj pas liferimit, cili do që skadon i pari, është në kundërshtim të plotë me kërkesën-kushtin administrativ të parashtruar nga AK në dosjen e tenderit sepse nga kjo rrjedh se OE i rekomanduar për kontratë mund ta liferoj pajisjen dhe të skadojë afati prej 24 muaj pa ndodhur ende instalimi dhe testimi i pajisjes në bllokun A4 si dhe pa u lëshuar certifikata nga TC-A, paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues/teknik sqaron se kërkesë e autoritetit kontraktues ka qene:

"Deklarate për afatin e garancionit 12000 orë pune , nga dita e lëshimit të certifikatës nga TC-A për operim të rregullt me bllokun A4".

Ndersa operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate në ofertën e tij ka ofruar garancion dymbëdhjetë mijë (12,000) orë pune pas datës së instalimit, ose njëzet e katër (24) muaj pas dorëzimit të pjesëve në sit, cilado që skadon e para.

Ne vazhdimi kemi paraqitur deklaratën e operatorit ekonomik i rekomanduar për kontrate:

1.11 Technical qualifications

1.11.1 Warranty and performances

The warranty period of the Products shall expire twelve-thousands (12,000) running hours after the date of installation of the Products in the equipment, or twenty-four (24) months after the delivery of the parts to the site whichever expires first.

The warranty and performance conditions are valid if and only if: the spare parts already available at site, within Company warehouse, are conform to genuine parts Company purchases all spares indicated by EO as deemed necessary for replacement.

AK me rastin e vlerësimit të ofertave përmes letres standarte ka kërkuarë sqarime shtesë nga OE i rekomanduar lidhur me deklaraten e lartëcekur dhe e njëjta OE me datën 28.08.2020 ka dhën sqarim se "garancioni per turbine/generator do të jetë 12,000 orë pune", paneli shqyrtues konstaton se deklarimi në propozimin teknik të dorëzuar nga OE i rekomanduar me dosjen e tenderit, ku ka theksuar se "garancioni do të skadojë 12,000 orë pas datës së instalimit të produktit apo 24 muaj pas liferimit, cilado që skadon e para, është në kundërshtim të plotë me kërkesën-kushtin administrativ të parashtruar nga AK në dosjen e tenderit ku ka qenë e theksuar qartë se operatoret ekonomik duhet të dorëzoinë "Deklarate për afatin e garancionit 12000 orë pune , nga dita e lëshimit të certifikatës nga TC-A për operim të rregullt me bllokun A4" si dhe sqarimi i kërkuar në fazen e vlerësimit nga AK lidhur me deklaraten në fjalë, është në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së dhe nenin 39 të RRUOPP sepse përmes këtyre dispozitave u mundësohet autoriteteve kontraktuese dhe operatoreve ekonomik që të sqarojnë dhe plotësojnë dokumentacionin që ka paqartësi dhe që mund të vërtetohen se kanë ekzistuar para datës së dorëzimit të ofertës, e jo si në rastin konkret që të bëhet ndryshim substancial duke i mundësuar operatorit ekonomik që ta ndryshojë deklaraten e cekur në propozimin teknik të dorëzuar me ofertë e cila ka qenë e qartë dhe në kundërshtim me kushtin administrativ të vendosur nga AK në Aneksin 1 të dosjes së tenderit. Andaj paneli shqyrtues perkunder ekspertit shqyrtues/teknik konstaton se pretendimi ankimor i OE ankues ne këtë pikë është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, që ka të bëjë me :

1. Po ashtu OE "Dietsmann Technology S.A" i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm sepse nuk ka dorëzuar dëshmi lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional. respektivisht lidhur me kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT për pikën:

2. Lista e personelit qe do te angazhohet ne realizimin e projektit: a) Menaxheri i projektit, duhet te këtë përvojë ne udhëheqjen e se paku tri riparimeve kapitale te turbinës dhe gjeneratorit elektrik. Te dëshmohet me CV, kopje te diplomës dhe kontratë pune."

OE i rekomanduar për kontratë lidhur më kërkesën/dëshminë e lartë cekur nuk ka dorëzuar fare listë me emra të personelit qe do ti angazhon në këtë projekt- përveç që në dokument propozimin teknik ka specifikuar llojet e profesioneve të stafit që nevojiten për implementimin e projektit, por pa e specifikuar asnjë emër të personave/stafit që i ka në dispozicion, respektivisht që do ti angazhon në implementimin e projektit dhe që janë të profesioneve siç i ka specifikuar profesionet edhe vet OE në propozimin teknik.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se kërkesë e AK-së është:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 .

Kualifikimet shkollore dhe profesionale te personelit.

Lista e personelit qe do te angazhohet ne realizimin e projektit.

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ne ofertën e tije nuk ka dorëzuar listë me emra të personelit qe do ti angazhon në këtë projekt- përveç që në dokument propozimin teknik ka specifikuar llojet e profesioneve të stafit që nevojiten për implementimin e projektit, por pa e specifikuar asnjë emër të personave/stafit që i ka në dispozicion, mirëpo as në dosjen e tenderit nuk ka qenë kërkese decidive qe lista e personelit të jete me emrat e punëtoreve që do te angazhohen por vetëm është specifikuar lista e personelit qe do te angazhohet ne realizimin e këtij projekti. Rrjedhimisht nga faktet e lartëcekura paneli shqyrtues perkunder ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është pjesrishtë i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues se po ashtu, OE i rekomanduar për kontratë, lidhur me projekt menaxherin z. Karim Mikati të caktuar për menaxhim të kontratës, nuk ka ofruar dëshmi se i njëjti ka përvojë në udhëheqjen e së paku tri riparimeve kapitale të turbinës dhe gjeneratorit elektrik siç është kërkuar nga AK si dhe për të njëtin projektmenaxher është dorëzuar kontrata e punës e lidhur me kompaninë "D.M.N. STAFFING SERVICES LTD" me adress në Nicosia, Qipro dhe se kjo kontratë e punes nuk ka lidhje me operatorin e rekomanduar për kontratë "Dietsman Technology S.A." me adresë zone industrielle 31260 salies du salat France, me të cilen vërtetohet se z.Karim Mikati nuk është punëtor i OE të rekomanduar për kontratë.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se kërkesë e autoritetit kontraktues ka qene: Menaxheri i projektit, duhet të ketë përvojë ne udhëheqjen e se paku tri riparimeve kapitale te turbinës dhe gjeneratorit elektrik. Te dëshmohet me CV, kopje te diplomës dhe kontratë pune, për të sqaruar me mirë ketë pikë Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtese për menaxherin e projektit.

3. In regard to Project Manager, the following documents are required: the copy of the diploma as well as the employment contract with the company "Dietsmann Techologies".

pas sqarimeve shtese operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate është përgjigjur dhe ka dorëzuar një deklarat personale te nenshkruar nga vetë z.Karim Mikati i cili ka deklaruar se ka realizuar me shume se 3 projekte për riparim të turbinës gjeneratorit mirëpo nuk ka bashkangjitur ndonjë deshmi tjeter të leshuar nga ndonjë palë e tretë për të dëshmuar se i njejti i ka menagjuar-udhëhequr se paku tri riparime kapitale te turbines dhe gjeneratorit elektrik, po ashtu në ofertën e tij ka ofruar CV për menaxherin e projekti si dhe për të njëtin projektmenaxher është dorëzuar kontrata e punës e lidhur me kompaninë "D.M.N. STAFFING SERVICES LTD" me adress në Nicosia, Qipro, mirëpo pa ofruar ndonjë dëshmi shtesë se kjo kontratë e punes respektivisht nderlidhjen mes kompanisë "D.M.N. STAFFING SERVICES LTD" me adress në Nicosia, Qipro me operatorin e rekomanduar për kontratë "Dietsman Technology S.A." me adresë zone industrielle 31260 salies du salat France, andaj bazuar në këto fakte vërtetohet se z.Karim Mikati nuk është punëtor i OE të rekomanduar për kontratë dhe për të njëjtin nuk janë dorëzuar dëshmi të mjaftushme për ta plotësuar kërkesën e parshtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosje e tenderit. Rrjedhimisht nga

faktet e lartëcekura paneli shqyrtues perkunder ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankuese se operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar me ofertë deklaratat lidhur me intervenimet në rast defekteve brenda 72 orëve si dhe deklaraten për garancionin prej 12,000 orë pune për pjeset që ndërrohen gjatë periudhës së garancionit siç ka kërkuar AK, por me rastin e kërkesës për sqarime nga ana AK është përgjigjur OE "Dietsman Technology S.A.", paneli shqyrtues sqaron se kërkesa e AK ka qenë që operatoret ekonomik të dorëzoj, deklaratë lidhur me intervenimet në rast defekteve brenda 72 orëve pas dates së njoftimit nga AK si dhe deklaraten për garancionin prej 12,000 orë pune për pjeset që ndërrohen gjatë periudhës së garancionit, mirëpo OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar deklaratat më rastin e dorëzimit të ofertes por me rastin e kthimit të përgjigjjes në sqarimin e kërkuar nga AK, është deklaruar në përgjigjje rreth dy kërkesave të lartë cekura, por pa dorëzuar deklaratë të veqant. Rrjedhimisht nga faktet e lartëcekura paneli shqyrtues konstaton se pretendimet ankimore janë pjesrishtë të bazuara.

Lidhur me pretendimet e ankimore të **OE "N.T.SH Ekoninvest"- Prishtinë** që nderlidhen me:
Sa i përket referencave të paraqitura nga OE i rekomanduar për kontratë, ne pas analizës të të gjitha dokumenteve të dërguara për "referenca" kemi vërejtur që ansnjëra nga këto dokumente nuk përmbush kushtet e paraqitura nga vet AK, ku kërkohen 2 referenca që dëshmojnë se është kryer punë në remontit kapital të turbinës dhe gjeneratorit.
Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik, sqaron se kërkesa e autoritetit kontraktues ka qene: Se paku 2 (dy) referenca ne vlere prej 3,000,000.00 € për përfundimin me sukses te punëve ne riparime kapitale te turbinës dhe gjeneratorëve elektrik me kapacitet te ngjashëm ne periudhën e shkuar trevjeçare nga data e publikimit te njoftimit për kontrate. Te dëshmohet me reference të lëshuar nga punëdhënësi për kryerjen me sukses te punëve.
Lidhur me këtë pretendim ankimor paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues/teknik sqaron se OE i rekomanduar për kontrate ne ofertën e tij ka ofruar dy referenca që dëshmojnë se është kryer punë në riparimin kapital të turbinës dhe gjeneratorit.
Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ne ofertën e tije ka ofruar referenca për riparime kapitale të turbinës dhe gjeneratorëve me kapacitetet të ngjashme.
Referenca për nr. te kontratës 4620007430 e datës 29.12.2017 lëshuar nga AK- PJSC Enel Rusi për riparimin kapital te pajisjeve TGB 300 njësia nr. 3 ku është bere riparimi i TGJ. (REF 9 i referohet OE ankues- Dëshmia).

Certifikata për përfundimin e punëve për njësinë nr.10 gjatë riparimit kapital për periudhën 01.07.2017-09.10.2017, T'300-240 lëshuar nga AK- PJSC Enel Rusi. (REF 10 i referohet OE ankues-Dëshmia).
Certifikata për përfundimin e punëve për njësinë nr. 8 gjate riparimit kapital për TGJ TG-8, e lëshuar me date 29.06.2018 nga AK PJSC Enel Rusi.(REF 14 i referohet OE ankues-Dëshmia).
Ndërsa referencat tjera dhe autoriteti kontraktues nuk i ka pranuar pasi qe nuk i ka cilësuar te natyrës se ngjashme dhe te cilat kane qenë më të vjetra se tre vite. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimet e ankimore të OE ankuese se sa i përket Projekt Menaxherit pas kërkesës ne pyetjen sqaruese OE është përgjigjur dhe ka deklaratën se ka realizuar minimum tri projekte për riparim te turbine gjenerator T-GJ ku plotësohet kushti i kërkuar për PM sepse me dëshminë e ofruar ne CV dhe deklaratën ne pyetjet sqaruese komisioni konstaton se është plotësuar ky kusht, ne kërkesën e dosjes se tenderit është kërkuar qe projekt menaxheri përmes CV dhe deklaratave te dëshmoj punën e tij. PM Karim Mikati ne CV e dhënë ka deklarua se nga viti 2017 - prezent është i punësuar ne Dietsmann Technologies S.A., këtë e dëshmon edhe kontrata e bashkangjitur ne pyetjet sqaruese.
Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se kërkesë e autoritetit kontraktues ka qene: Menaxheri i projektit, duhet të ketë përvojë ne udhëheqjen e se paku tri riparimeve kapitale te turbinës dhe gjeneratorit elektrik. Te dëshmohet me CV, kopje te diplomës dhe kontratë pune, për të sqaruar me mirë ketë pikë, autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtese për menaxherin e projektit.

3. In regard to Project Manager, the following documents are required: the copy of the diploma as well as the employment contract with the company "Dietsmann Techologies".

pas sqarimeve shtese operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate është përgjigjur dhe ka dorëzuar një deklarat personale te nenshkruar nga vetë z.Karim Mikati i cili ka deklaruar se ka realizuar me shume se 3 projekte për riparim të turbinës gjeneratorit mirëpo nuk ka bashkangjitur ndonjë deshmi tjeter të leshuar nga ndonjë palë e tretë për të dëshmuar se i njejti i ka menagjuar - udhëhequr se paku tri riparime kapitale te turbines dhe gjeneratorit elektrik, po ashtu në ofertën e tij ka ofruar CV për menaxherin e projekti si dhe për të njëtin projektmenaxher është dorëzuar kontrata e punës e lidhur me kompaninë "D.M.N. STAFFING SERVICES LTD" me adress në Nicosia, Qipro, mirëpo pa ofruar ndonjë dëshmi shtesë se kjo kontratë e punes respektivisht nderlidhjen mes kompanisë "D.M.N. STAFFING SERVICES LTD" me adress në Nicosia, Qipro me operatorin e rekomanduar për kontratë "Dietsman Technology S.A." me adresë zone industrielle 31260 salies du salat France, andaj bazuar në këto fakte vërtetohet se z.Karim Mikati nuk është punëtor i OE të rekomanduar për kontratë dhe për të njëjtin nuk janë dorëzuar dëshmi të mjaftushme për ta plotësuar kërkesën e parshtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosje e tenderit. Rrjedhimisht nga faktet e lartëcekura paneli shqyrtues përkunder ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimet e ankimore të OE ankuese se OE i rekomanduar për kontratë ka mungesë të dëshmive për pajisjet mobile për përpunimet e CPL, CPM dhe CPU, mungesës së dëshmive për pajisjet për matjen e vibrimeve për analizë dhe balancim, nuk posedon pajisje për balancim deri në 3000 rrotullime si dhe nuk posedon pajisjet në pozicionet 14 deri 17 ashtu siç kërkohet në dosjen e tenderit për më tepër, ky OE ka pranuar se nuk i ka ato pajisje dhe ka deklaruar se do të tentojë të ketë në dispozicion përmes nënkontraktorëve këto pajisje, paneli shqyrtues konstaton se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmit lidhur me paisjet e kërkuara nga AK mirëpo vetëm ka potencuar se paisjet e kërkuara do të sigurohen përmes nënkontraktorve, deklarata e tillë nuk ofron kurrfarë sigurie që pajisjet do të jenë në dispozicion të operatorit ekonomik për të kryer punën. Rrjedhimisht nga faktet e lartëcekura paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është pjesrisht i bazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankuese se OE i rekomanduar për kontratë nuk posedon deklaratën për posedimin e stafit, mirëpo ky OE ka deklaruar se do të tentojë të sigurojë stafin. Kjo deklaratë e OE të rekomanduar për kontratë nuk ofron siguri se do të ketë kuadrin e specializuar për punët në këtë kontratë dhe është në kundërshti të plotë me kërkesat e AK për këtë pike, paneli shqyrtues konstaton se operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ne ofertën e tije nuk ka dorëzuar listë me emra të personelit qe do ti angazhon në këtë projekt- përveç që në dokument propozimin teknik ka specifikuar llojet e profesioneve të stafit që nevojiten për implementimin e projektit, por pa e specifikuar asnjë emër të personave/stafit që i ka në dispozicion, mirëpo as në dosjen e tenderit nuk ka qenë kërkese decidive qe lista e personelit të jete me emrat e punëtoreve që do te angazhohen por vetëm është specifikuar lista e personelit qe do te angazhohet ne realizimin e këtij projekti. Rrjedhimisht nga faktet e lartëcekura paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është pjesrishtë i bazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankuese ne lidhje me eliminimin e saj nga AK, paneli shqyrtues sqaron se OE ankuese është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit me arsyjet me certifikaten e pranimit nr.400 qe nderlidhet me bllokun A3 i cili është ende nën garancion me probleme të kohëpaskohshme", arsyja e dytë nderlidhet me atë se gabimisht është konkluduar se punët në gjenerator janë kryer nga SE Planet Electrosystems si dhe arsytimit që jemi mbi buxhet, kjo nuk duhet te jetë arsyetim për eliminim dhe nuk është pikë që komisioni vlerësues i AK është dashur ta cekë në letrën standarte për eliminim, paneli shqyrtues konstaton se arsyjet e eliminimit të OE ankuese ndërlidhen me kontratat që janë realizuar nga OE ankuese në vetë autoritetin kontraktues dhe është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht e komisionit te vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit te tenderuesve, të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin për

kontratë dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1 si dhe vlerësimin e tenderëve në përputhshmëri me kriteret e vendosura në FDT si dhe të informoj operatoret ekonomik pjesmarres më rezultatin e nxjerrur rreth ofertes së tyre të dorëzuar mirëpo duke i sqaruar dhe faktuar arsyjet e eliminimit dhe në rastin konkrete AK respektivisht komisioni i vlerësimit lidhur me dy arsyjet e para të eliminimit është dashur ti faktoj se lidhur me projektet te cilat janë në implemetim apo janë implemetuar janë dhën vërejtje apo hartuar raporte nga zyrtar të AK, me anë të të cilave janë paraqitur problemet e kohëpaskohshme apo se punët janë kryer nga kompani tjera e jo vetëm të ceken arsyjet e eliminimit në formen e tillë. Po ashtu është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht e komisionit te vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit te tenderuesve, të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve si dhe të zbatoj piken 2.1 të paragrafit 2 të nenit 62 të LPP-së në rastet kur tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Rrjedhimisht nga faktet e lartëcekura paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është pjesrishtë i bazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të **grupit të OE ankuese "Intrast shpk&Sulzer Turbo Venlo B.V & Turgan Enerji Sanay Ticaret A.S"** e cila pretendon që i rekomanduari për kontrate ka paraqitur ISO 9001 dhe 14001 të skaduar me 17.04.2020 që është para datës së ofertimit e cila ka qen 28.05.2020.
Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë në momentin e ofertimit ka ofruar ISO certifikata me afat te skaduar, dhe më pas AK–ja i ka kerkuar informata shtesë OE te rekomanduar per kontrate lidhur me Certifikatat ISO, ndersa paneli shqyrtues sqaron se OE i rekomanduari për kontratë me rastin e sqarimeve i ka ofruar AK-së certifikaten ISO të lëshuar me datën 12.06.2020 me qka konstatohet se kjo certifikatë e ISO 9001 dhe 14001 është lëshuar pas dates së ofertimit e cila ka qenë 28.05.2020 si dhe sqarimi i kërkuar në fazen e vlerësimit nga AK lidhur me certifikatën e ISO 9001 dhe 14001 të dorëzuar nga OE i rekomanduar me datë të skaduar me 17.04.2020, është në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së dhe nenin 39 të RRUOPP sepse përmes këtyre dispozitave u mundësohet autoriteteve kontraktuese dhe operatoreve ekonomik që të sqarojnë dhe plotësojnë dokumentacionin që ka paqartësi dhe që mund të vërtetohen se kanë ekzistuar para datës së dorëzimit të ofertës, e jo si në rastin konkret që të bëhet ndryshim substancial duke i mundësuar operatorit ekonomik që ta ndryshojë certifikaten respektivisht ta plotëson oferten me certifikaten e ISO 9001 dhe 14001 të lëshuar me datën 12.06.2020. Andaj paneli shqyrtues përkunder ekspertit shqyrtues/teknik konstaton se pretendimi ankimor i OE ankues ne këtë pikë është i bazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të grupit të OE ankuese "Intrast shpk&Sulzer Turbo Venlo B.V & Turgan Enerji Sanay Ticaret A.S" që nderlidhen me dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontrate:

Ne dosje te tenderit ne aneksin 1 - Specifikimet teknike te detyrueshme shprehimisht janë kërkuar:

Deklarata qe posedon pajisje për balancim të rotorit deri në 3000 rrotullim.

d) Deklaratë se posedon të gjitha veglat dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e riparimit kapital.

OE nuk e ka deklaratën qe posedon pajisje për balancim te rotorit.

Ne dokumentin KEK-20-620-5-1-1jQualification Evidence _ Technical ProposalrevOO, ne një resht ka thënë : EO states to get available, via suitable subcontractor, a rotor balancing equipment up to 3000 revolutions.

Përkthe. OE deklaron se do ta këtë ne dispozicion, përmes një nënkontraktoni te përshtatshëm pajisjen për balancim te rotorit deri ne 3000 rrotullime. Me këtë rast nuk e ka përmendur fare se cili është nënkontraktoi, për me tepër ne dosje te tenderit është kërkuar qe OE ta këtë pajisjen për Balancim te rotori.

Përkunder ekspertit shqyrtues/teknik të cilet sqarojnë se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate deklaron që të marrë në dispozicion, përmes nënkontraktonit të përshtatshëm, një pajisje të balancimit të rotorit deri në 3000 rrotullime.

OE deklaron që të marrë në dispozicion, përmes nënkontraktonit të përshtatshëm, kornizën e specializuar për punët e mëposhtme: diagnostifikimi, salduesit e certifikuar, riparimi, ngarkimi i sistemit të turbinës vajore mekanike-hidraulike ngarkimi për ngarkesë 200 MW, paneli shqyrtues konstaton se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmit lidhur me paisjet e kërkuara nga AK mirëpo vetëm ka potencuar se paisjet e kërkuara do të sigurohen përmes nënkontraktorve, deklarata e tillë nuk ofron kurrfarë sigurie që pajisjet do të jenë në dispozicion të operatorit ekonomik për të kryer punën. Rrjedhimisht nga faktet e lartëcekura paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është pjesrisht i bazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të grupit të OE ankuese "Intrast shpk&Sulzer Turbo Venlo B.V & Turgan Enerji Sanay Ticaret A.S" që nderlidhen me dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontrate:

OE është i obliguar të garantojë vibrimet horizontale dhe vertikale në të gjitha kushinetat e turbo gjeneratorit, të cilat duhet te jenë nën ose rreth 3.8 mm/s.(ZONA A)

OE nuk ka deklaruar se do ti garantoje vibrimet horizontale dhe vertikale vertikale në të gjitha kushinetat e turbo gjeneratorit, të cilat duhet te jenë nën ose rreth 3.8 mm/s.(ZONA A)

OE është i obliguar që për temperatura të vajit 45 °C pas ftohësve të vajit, temperatura e materialit të bardhe të kushinetave të turbogjeneratorit duhet të jetë < 75 °C, derisa temperatura e vajit në dalje nga kushinetat duhet të jetë nën < 60 °C.

OE nuk ka deklaruar se do ti garantoje që për temperatura të vajit 45°C pas ftohësve të vajit, temperatura e materialit të bardhe të kushinetave të turbogjeneratorit duhet të jetë < 75°C, derisa temperatura e vajit në dalje nga kushinetat duhet të jetë nën < 60 °C.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se kërkesë e autoritetit kontraktues ka qene tek aneksi 1.

Të gjitha pikat e poshtë shënuara nga nr. 1 deri tek nr. 9 duhet ekzekutuar nga operatori ekonomik.

1. Matjet diletative ne turbine
2. Vibracionet ne Turbine (kushineta).
3. Temperaturat e metalit te bardhe
4. Temperaturat e gjeneratorit ne stator (FE-CU).
5. Temperaturat e Hidrogjenit (gazrave)
6. Temperaturat ujit për ftohje te hidrogjenit
7. Temperaturat e vajit ne kushinetat puthiteshe
8. Matja e temperaturës ne shtypjen e mesme dhe te larte .
9. Matja e temperaturës ne gjenerator

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ka sqaruar ne piken 48 .

48. Recording and adjustment of static properties of control system after oil flushing of integral pipe system, lubrication system, governing system, and oil sealing system for generator - cold condition. Mirëpo ky sqarim i dhën ne piken 48 nga OE i rekomanduar për kontratë nuk i përfshinë në menyrë decidive të gjitha pikat e aneksit 1(nga nr. 1 deri tek nr. 9) të paraqitura nga AK në dosjen e tenderit edhe pse këto pika janë kërkesa obligative që duhet ti përmbush operatori ekonomik me rastin e implementimit te kontrates. Andaj paneli shqyrtues përkunder ekspertit shqyrtues/teknik konstaton se pretendimi ankimor i OE ankues ne këtë pikë është pjesrishtë i bazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të grupit të OE ankuese "Intrast shpk&Sulzer Turbo Venlo B.V & Turgan Enerji Sanay Ticaret A.S" që nderlidhen me dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontrate:

OE ka prezantuar një liste te referencave prej 5 projekteve të përfunduara.

Referenca ne liste me nr. 3 OE Dietsmann ka qene ne konzorcium me OE URALENERGOREMOT JSC, ku ne përkthimet e dërguara shihet qarte se te gjitha punët janë kryer nga kompania URALENERGOREMOT JSC, e jo nga OE Dietsmann.

Referencat tjera me nr. 4,5,6 janë vetëm te valvave te turbinës e gjeneratorit, nuk janë remonte kapitale.

Paneli shqyrtues ekspert shqyrtues/teknik sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ne ofertën e tij ka ofruar dy referenca qe dëshmojnë se është kryer pune ne riparimin kapital te turbinës dhe gjeneratorit.

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ne ofertën e tij ka ofruar referenca për riparime kapitale te turbinës dhe gjeneratorëve me kapacitetet të ngjashme.

Referenca për nr. te kontratës 4620007430 e datës 29.12.2017 lëshuar nga AK- PJSC Enel Rusi për riparimin kapital te pajisjeve TGB 300 njësia nr. 3 ku është bere riparimi i TGJ.

Certifikata për përfundimin e punëve për njësinë nr.10 gjatë riparimit kapital për periudhën 01.07.2017-09.10.2017, T'300-240 lëshuar nga AK- PJSC Enel Rusi.

Certifikata për përfundimin e punëve për njësinë nr. 8 gjate riparimit kapital për TGJ TG-8, e lëshuar me date 29.06.2018 nga AK PJSC Enel Rusi. Andaj pretendimi ankimor ne këtë pik është i pa bazuar .

Lidhur me pretendimet ankimore të grupit të OE ankuese "Intrast shpk&Sulzer Turbo Venlo B.V & Turgan Enerji Sanay Ticaret A.S" që nderlidhen me arsyjet e eliminimit të saj nga AK:

Dokumenti i cekur ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar ku keni kërkuar ndryshimin e çmimit është dorëzuar ne ofertën e juaj dhe komisioni ofertën e juaj e ka shqyrtuar ne tërësi dhe ka arsyetuar se nuk lejohet ndryshimi i çmimit, ndërsa deklarata e juaj për kushtet e përgjithshme Declaration on the "General conditions of sealer and terms of delivery" e datës 16.09.2020 nuk mund te pranohet pasi qe substancialisht ndikon ne çmimin e ofertës te dorëzuar me date 28.05.2020. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ankues, ka ofruar Declaration on the "General conditions of sealer and terms of delivery" e datës 16.09.2020, e cila për AK ndikon ne çmimin e ofertës ndërsa OE ankues thotë se këtë deklaratë e kanë bere për anëtarët e konzorciumit. Andaj pretendimi ankimor ne këtë pik është i pa bazuar .

Lidhur me pretendimin ankimore që ka të bëjë me :

Pika 2.

- For the member of the consortium Turgan Energi sanayi Ticaret reference number 46, issued by: AK-Karachi "Nuclear Powerplant Pakistan" is not acceptable as it is not of similar capacity, it has a capacity of 135 MW, while the Turbogenerator in TCA is 200 MW which is for 32.5% smaller;

JU je dosje te tenderit keni kerkuar referenca per turbina dhe gjenerator te kapacitetit te ngjashem, nuk e keni specifikuar se sa duhet te jete minimumi i kapacitetit te turbogjenratorit, rrjedhimisht parimi i punes dhe madhesia eshte e ngjashme.

Pika 3 dhe 4.

- Reference No. 1 in the list issued by T + Group Russia for the Economic Operator "Sulzer Turbo Service" has no data that meets our requirements, also lacks the contract number, capacity and year of completion of the contract;
- Reference no.2 in the list of References does not have sufficient data and was issued on: 28.07.2017 by "PJSC - Power Machine Russia" for the consortium Power Machine and Sulzer Turbo Service, also lacks the contract number, capacity and year of implementation, so it is not a Major Overhaul but a preventive maintenance;

Referancat e prezantuara dhe te realizuara nga Sulzer, e kane te bashkangjitur edhe nje dokument shpjegues, ne te cilin qarte shkruan se nese ka mangesi apo nse doni te vertetoni mund ti pyetni leshuesit e referencave qe ne kete rast jane kompanite Prodhuese te energjise si: T+Group Russia, dhe PJCS Power Machine Russia. Kontaktet e tyre jane ne referenca.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se referencat e operatori ekonomik ankues nuk janë konform DT-se sepse nuk përmbajnë te dhëna të mjaftueshme të cilat e përmbushin kërkesën e dosjes se tenderit.

Ref. 2 nuk ka te dhëna te mjaftueshme edhe është lëshuar 28.07.2017, i mungon numri i kontratës kapacitet dhe viti i zbatimit dhe nuk është një riparim kryesor por vetëm një mirëmbajtje parandaluese.

Pika2. Nuclear poker plan Pakistan nuk është i pranueshëm pasi nuk është i kapacitetit te njëjtë i cili ka një kapitet prej 135MW ndërsa tubo gjeneratorët ne TCA është 200MW që është për 32.5% me i vogël, andaj ky operator ekonomik nuk i përmbushë kërkesa e dosjes se tenderit .

Lidhur me pretendimin ankimore që ka të bëjë me :

Pika 5.

You have declared for the guarantee for parts replacernent withln the warranty period 12000 hours, while 12000 working hours are required after their replacement (Albaman language version prevarls).

Në dokumentin e garancionit e kemi kopjuar pikërisht ashtu siç është kërkuar ne dosje te tenderit, ashtu siç kemi deklaruar dhe e cila nënkuptohet qe garancioni fillon pas lëshimit te të certifikatës nga TC-A për operim të rregullt me bllokun A4, për 12000 ore pune, ashtu siç është kërkuar ne dosje te tenderit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues / teknik sqaron se kërkesë e autoriteti kontraktues ka qene 12000 ore pune kërkohet pas zëvendësimit te tyre, ndërsa operatori ekonomik ankues ka deklarua për garancinë për ndërrimin e pjesëve brenda periudhës se garancisë 12000, qe është ne kundërshtim me kërkesën e DT. Andaj ky pretendim ankimore është i pa bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqaron se është përgjegjësi dhe ne diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht e komisionit te vlerësimit qe gjatë procesit te vlerësimit te tenderuesve, të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1 si dhe vlerësimin e tenderëve në përputhshmëri me kriteret e vendosura në FDT.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqaron se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, me rastin e rivlerësimit duhet te respektoj ne tërësi nenin 59, te LPP-së, andaj është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht komisionit të vlerësimit dhe zyrtarit përgjegjës të prokurimit, që procesi i

vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit te ofertave, të behet në harmoni të plotë me kërkesat e kualifikimit të specifikuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit si dhe dispozitat ligjore te LPP-se.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqaron se autoriteteti kontraktues është i obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - " Korporata Energjetike e Kosovës " (KEK);

1x1 OE - "Ballkan Petrol" SH.P.K- Ferizaj;

1x1 OE: N.T.SH "Ekoninvest" – Prishtinë;

1x1 OE: "Itrast " SH.P.K & "Selzer Turbo Venlo"B.V & "Tugran Enerjisanayi Ticaret"A.S-Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.